



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:030004

Datë: 03.11.2023

Numri i dokumentit: 04874971

**P.nr.828/22**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit A.E. nga F.K., i akuzuar për veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.25/20 të dt.03.04.2020, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 19.10.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Nazmi Krasniqi dhe të akuzuarit A.E., me mbrojtësin sipas autorizimit av. Afrim Salihu, me datë 23.10.2023 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 02.11.2023 përpiloi këtë

### A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.E., e biri i Rr. dhe nëna N., e gjinisë P., i lindur me ..., në P., me vendbanim në rr. “...” nr... F.K., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës

### ËSHTË FAJTOR

**Sepse:**

Me datën 13.02.2020 rreth orës 20:00, në rrugën “M.” nr.. në F.K., derisa Njësia e Hetimeve e Stacionit Policor në F.K. gjatë ushtrimit të kontrollit në lokalit të cilin gjendet në rrugën “M.” nr..., pronar i të cilit është i pandehuri, janë hasur pajisje të lojërave të fatit dhe kuponë të shtypur të këtyre lojërave me datat 08.02 deri me 10.02.2020 e që dëshmojnë se në lokal ishin organizuar lojëra të fatit të cilat janë të ndaluara me ligj.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve , 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 46, 47,48, 69, 70, 71, 72 dhe 294 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

### DËNIM ME KUSHT

- I. Për veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së, të akuzuarin A.E., Gjykata e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (8) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse në periudhën verifikuese prej një (2) viti i akuzuari nuk kryen tjetër penale.
- II. Gjykata konform nenit 277 KPPRK-së, URDHËRON konfiskimin e përhershëm të sendeve: Laptop “Dell”, Adapter i Laptopit “Dell”, DVR Technicolor, Adapter DVR, Aparat për tiketa “TYSSO”, Adapter i shtypësit për tiketa, TV BOX i shtypësit për tiketa, Kabull HDMI, Kupona të shtypur të datës 08.02.2020-10.02.2020, Dy rolle letër printer të tiketave të shtypura, Televizor “Samsung”, Televizor Premium, Aparat i lojërave “Sharp” dhe tre çelësa të aparatit të lojërave dhe pas plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi sendet e konfiskuara të dorëzohet në Agjencionin për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara ose të Konfiskuara.
- III. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 30 (tridhjetë) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.25/20 të datës 03.04.2020, ndaj të akuzuarit A.E. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datën 16.10.2023, i akuzuari është deklaruar i pafajshëm pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit. Gjykata, në këtë çështje penalo juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 19.10.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Nazmi Krasniqi, të akuzuarit A.E. dhe mbrojtësit sipas autorizimit av. Afrim Salihu, ku mbrojtësi e njofton Gjykatën se tërhiqemi nga kundërshtimi i provave dhe kërkesës për hedhje të aktakuzës me arsyetimin se kemi kërkuar që të mbahet kjo seancë është sepse që ne fillimin e hetimeve kam parashtruar kërkesën për negociim të pranimit të fajësisë por që kalojë kohë e gjatë dhe nuk është realizuar, në cilësinë e mbrojtësit e kam njoftuar të akuzuarin lidhur me benefitet e pranimit të fajësisë dhe jemi të deklarohemi lidhur me aktakuzën. Pasi që i akuzuari ka hequr dorë nga leximi i aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit ka mbështetur deklarinimin mbi pranimin e fajësisë, se pranimi i fajësisë është bere pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si mbrojtës, e i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë dhe pranimin e veprës penale e bene ne mënyrë vullnetare.

Prokurori i shtetit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi që pranimi i fajësisë behet ne mënyre vullnetare, i pandehuri është i vetëdijshëm, me pasojat e pranimit të fajësisë si dhe pranimi i fajësisë është ne përputhje të plote me provat dhe gjendjen faktike të përshkruar në aktakuze.

Konform nenit 322, Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është e vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarinin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve, ku Prokurori i Shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se me vete pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit veprimet faktike të përshkruara si në dispozitiv të aktakuzës u dëshmuara se aktakuza është e ligjshme dhe i pandehuri me veprimet e tij ka kryer veprën penale e cila i vihet në barre sipas aktakuzës për çka të njëjtin e konsiderojmë përgjegjës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, ku me rastin e llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësues gjykata ta ketë parasysh pranimin e fajësisë. I propozojmë gjykatës, që konform dispozitivave të KPPRK-se që të konfiskoj sendet të cilat janë të regjistruara si në urdhrin për konfiskim të përkohshme me datën 18.09.2019.

I akuzuari A.E. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se i vjen keq që ka ndodh ky rast, ka qene hera e pare që ka ra ndesh me ligjin dhe nuk do të përsëriten më veprimet e tilla.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. Afrim Salihu në fjalën përfundimtare ka deklaruar, meqenëse në këtë stad të procedurës i mbrojturi im pranoj fajësinë sipas aktakuzës, tek matja e dënimit nga ana e gjykatës i propozoj të ketë parasysh rrethanat e mëposhtme lehtësuese si pranimi i fajësisë, po ashtu shpreh keqardhje lidhur me rastin dhe nga sjelljet e mëparshme personale nuk janë evidentuar që i njëjti të portretizohet si recidivist, është mbajtës i familjes dhe në aspektin financiar është i varfër, i propozoj gjykatës që pas shpalljes së dënimit tek lartësia e dënimit të ketë parasysh nenin 49 nga e cila tek vepra penale ku maksimumi i dënimit është 5 vite, gjykata mund të shqiptoj edhe dënim me kusht, kjo kërkesë është edhe nga i pandehuri edhe e imja sepse konsiderojmë me shqiptimin e dënimit me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarinimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 322 lidhur me nenin 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2020-AE-0180, i datës 13.02.2020; Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin A.E., i datës 04.03.2020 dhënë në Prokurorin Themelore në Prishtinë; Procesverbali i kontrollit të vendbanimeve, lokaleve dhe pasurisë i datës 13.02.2020 sipas urdhrin të Gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 14.02.2020; Kërkesa për lëshimin e urdhrin për sekuestrim të përkohshëm i datës 14.02.2020; Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve nga Policia e Kosovës, i datës 13.02.2020, për personin A.E.; si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit A.E. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer dhe kërkim faljen e tij. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit. Ndërsa si rrethanë rënduese ishte fakti se i pandehuri ka kryer këtë vepër penale me dashje.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 48 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 361 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.828/22 më datë 02.11.2023

**Bashkëpunëtori Profesional**

**Gjyqtarja e vetme Gjykuese**

**Albrim Kastrati**

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.